



Home Office

Udhëzues i Zyrës së Brendshme për

Jetesën në Strehimin Fillestar

Shqip



Qëllimi i këtij udhëzuesi

Ky udhëzues shërben kryesisht për azilkërkuesit që vendosen në Strehim Fillestar, ndërkohë që kërkesa e tyre për mbështetje në bazë të Seksionit 95 është duke u vlerësuar, në rastin kur atyre u është dhënë mbështetja në bazë të Seksionit 95 dhe janë në pritje të shpërndarjes ose marrin mbështetjen e parashikuar në Seksionin 4.

Në të gjendet informacion i vlefshëm për:

- 1.** Strehimin dhe shërbimet që mund të prisni të merrni nga ne
- 2.** Organizatat të cilat ofrojnë dhe kryejnë këto shërbime
- 3.** Çfarë presim ne prej jush
- 4.** Ku të raportoni problemet, shqetësimet dhe ndryshimet e rrethanave tuaja

Si duhet ta përdor këtë broshurë?

Ju lutemi lexojeni me kujdes këtë broshurë. Mbani shënim çdo informacion që është i rëndësishëm për ju dhe familjen tuaj. Kjo broshurë përmban shumë informacion, prandaj ju lutemi ruajeni atë në një vend të sigurt, në mënyrë që t'i referoheni më vonë.

Çfarë do të më thonë kur të mbërrij në strehim?

Kur të mbërrini në Strehimin Fillestar, personi i cili ju ofron strehimin do t'ju japë informacion që mund të jetë i dobishëm për ju në lidhje me:

- 1.** Strehimin që ju është ofruar.
- 2.** Sigurinë dhe mirëqenien individuale, ku përfshihet përdorimi i kujdesit shëndetësor urgjent ose emergjent.
- 3.** Shtrirjen dhe rutinën e vendndodhjes së Strehimit Fillestar dhe shërbimet e disponueshme.
- 4.** Instruksionet për përdorimin e pajisjeve, mjediseve dhe artikujve të instaluar të cilët ofrohen për komfort dhe jetesën në përgjithësi (kur është e aplikueshme).
- 5.** Procesin për përfitimin e kontrolleve mjekësore dhe shërbimeve përkatëse.

Ju do të merrni gjithashtu:

- 1.** Informacion në lidhje me ofruesin tuaj të strehimit dhe çfarë të prisni prej tyre.
- 2.** Informacion në lidhje me Migrant Help dhe çfarë të prisni prej tyre; dhe

3. Broshura që përmban "Udhëzime për të Drejtat dhe Pritshmëritë në Mbretërinë e Bashkuar lëshuar nga Zyra e Brendshme", e cila përfshin informacion rreth kulturës së Mbretërisë së Bashkuar dhe shërbimeve të disponueshme për ju gjatë qëndrimit tuaj në MB. Në rast se nuk e keni marrë atë, ju mund t'i kërkonti një kopje ofruesit tuaj të strehimit.

Në rast se nuk keni pasur një seancë informative gjatë prezantimit tuaj ose nuk i keni marrë këto burime, ju lutemi kërkojini ato nga ofruesi juaj i strehimit. Ruajini broshurat në një vend të sigurt për t'i lexuar sërish më vonë. Informacioni në këtë broshurë mund të gjendet në internet, si dhe në: <https://www.gov.uk/government/publications/living-in-initial-accommodation>

Ju lutemi vini Re: Ky dokument shërben vetëm si udhëzues dhe nuk zëvendëson ose vepron si ndonjë formë e politikës së publikuar. Udhëzuesi është krijuar kryesisht për ata që marrin mbështetje sipas Seksionit 98 të cilët janë në pritje të një vendimi në lidhje me aplikimin e tyre për mbështetje në bazë të Seksionit 95. Ky udhëzim zbatohet gjithashtu për njerëzit të cilëve u është dhënë mbështetja sipas Seksionit 95, por që mbeten në strehimin fillestar në pritje të shpërndarjes. Në rastet kur zbatohen dispozita të ndryshme për aplikantët e Seksionit 4(2) (azilkërkuesit e refuzuar që marrin ndihmë në bazë Seksionit 4(2) të Ligjit për Imigracionin dhe Azilin 1999), kjo rrethanë është pasqyruar.

Ju lutemi kontaktoni Migrant Help në rast se keni ndonjë shqetësim me strehimin ose mbështetjen tuaj, ose nëse mendoni se strehimi nuk është i përshtatshëm për ju (ose për personat që varen nga ju), për shembull, një nevojë për shkak të paaftësisë. Ata do t'i kërkojnë Zyrës së Brendshme dhe ofruesit të strehimit të hetojnë mbi shqetësimin dhe ta zgjidhin atë. Ju mund ta kontaktoni Migrant Help nëpërmjet:

Webchat në adresën

https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch


Ngrini një Problem nëpërmjet faqes së tyre të internetit:

(<https://ellis.custhelp.com/app/ask/session>)

Telefoni pa pagesë për linjën e ndihmës: 0808 8010503.

Në rast se keni kontaktuar me Migrant Help për shqetësimet që lidhen me strehimin dhe ato shqetësime nuk janë zgjidhur, ju mund të bëni një ankesë zyrtare kundër ofruesit tuaj, Zyrës së Brendshme ose Migrant Help. Ndonjëherë njerëzit shqetësohen se në rast se ankohen, Zyra e Brendshme do të refuzojë kërkesën e tyre për azil ose do të ndalojë së dhëni mbështetje financiare ose strehim. Kjo nuk është e vërtetë. Ankesat për strehim nuk kanë aspak ndikim në rezultatin e kërkesës tuaj për azil ose në klasifikimin tuaj për të marrë ndihmë dhe strehim.

Cilat janë organizatat e rëndësishme që janë të përfshira në ofrimin e strehimit dhe dhënies së mbështetjes për mua?

 <p>Home Office</p>	<p>Home Office [Zyra e Brendshme] e cila është përgjegjëse për ofrimin e strehimit të azilit në të cilin jetoni dhe për mbështetjen tuaj financiare.</p>
	<p>Migrant Help është një organizatë bamirëse, e pavarur nga Zyra e Brendshme, e cila është caktuar për t'ju dhënë këshilla, informacion në lidhje me mbështetjen tuaj, për të raportuar një shqetësim ose për të njoftuar Zyrën e Brendshme për një ndryshim të rrethanave tuaja, ju duhet të kontaktoni me Migrant Help me telefon në numrin 0808 8010 503, webchat në adresën https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch ose mund të Ngrini një Shqetësim në adresën https://ellis.custhelp.com/app/ask</p>
	<p>Ofruesi i strehimit tuaj. Zyra e Brendshme përdor kompani private për të siguruar strehimin për ju. Gjatë vendosjes, juve do t'ju caktohet një oficer për strehimin, i cili do t'ju mirëpresë në vendin ku do strehoheni dhe do t'i përgjigjet çdo pyetjeje.</p>
	<p>Autoritetet vendore, të cilat njihen gjithashtu si këshillat, janë pjesë e administratës shtetërore të cilat ofrojnë shërbime dhe mjedise publike në zonën tuaj, si për shembull shkollat dhe shërbimet sociale. Shërbimet vendore që ofrohen dhe kush i ofron ato varet nga vendi ku jetoni.</p> <p>Këshilli juaj vendor mund të gjendet duke përdorur kodin tuaj postar në këtë adresë: Find your local council - GOV.UK (www.gov.uk) Nëpërmjet faqes së internetit të këshillit tuaj vendor ju mund të gjeni informacion mbi shërbimet vendore si për shembull bibliotekat dhe grupet e mbështetjes.</p>

Çfarë duhet të bëni në një rast urgjence

Në rastin e një urgjence mjekësore që kërkon trajtim të menjëhershëm, ju duhet të telefononi menjëherë 999 dhe t'i tregoni operatorit të shërbimit se çfarë shërbimi ju nevojitet – Zjarr, Policia ose Ambulanca. Është e rëndësishme që ju t'i telefononi këta numra vetëm në raste urgjence.

Në rast se nuk flisni Anglisht, ju duhet të thoni emrin e gjuhës në të cilën dëshironi të flisni kur telefononi për herë të parë numrin 999. Juve do t'ju sigurohet një përkthyes nëse një i tillë është në dispozicion. Telefonatat në numrin 999 janë pa pagesë.

Policia: Në rast se dikush është i dhunshëm ose kërcënon të ushtrojë dhunë, ose nëse jeni dëshmitar ndërkohë që po kryhet një krim, ju duhet të telefononi 999 dhe të kërkonti policinë. Në rast se dëshironi të raportoni një krim ose keni qenë një viktimë e një krimi i cili nuk ka nevojë për reagim urgjent, ju duhet të telefononi në numrin **101**. Ju lutemi të jeni të sigurt se kontakti me Policinë nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në kërkesën tuaj për azil.

Zjarri: në rast se shihni zjarr ose shenja të zjarrit siç është tymi, ju duhet të aktivizoni alarmin më të afërt të zjarrit përpara se t'i drejtoheni personelit në strehimin tuaj për të telefonuar në numrin 999 për të kërkuar shërbimin e zjarrfikësve. Ju nuk duhet t'i afroheni ose të përpiqeni ta shuani një zjarr.

Ambulanca: në rast se ka një urgjencë mjekësore kur dikush është i sëmurë ose i plagosur rëndë dhe jeta e tij është në rrezik, ju duhet të telefononi në numrin **999** dhe të kërkonti një ambulancë. Për probleme mjekësore të përgjithshme të cilat nuk kanë nevojë për ambulancë, ju duhet të telefononi për këshillim në numrin **111**. Ju mund t'i drejtoheni personelit në strehimin tuaj për mbështetje në lidhje me këtë.

Shërbimet Utilitare: Në rast se ndjeni erën e gazit, ju duhet të telefononi menjëherë në numrin e urgjencës së National Grid Gas [Rrjeti Kombëtar i Gazit] **0800 111 999** për Anglinë, Skocinë dhe Uellsin ose **0800 002 001** për Irlandën e Veriut dhe më pas ta raportoni menjëherë problemin tek Migrant Help.



A keni ndonjë pyetje?

- > Shikoni broshurat e prezantimit dhe ato informuese
- > Vizitoni faqen www.gov.uk/browse/Mastercards-immigration/asylum ose www.migranthelpuk.org
- > Telefononi Migrant Help në numrin **0808 8010 503**, webchat në adresën https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch ose Ngrini një Shqetësim në adresën <https://ellis.custhelp.com/app/ask>

Përmbajtja

SEKSIONI 1 LLOJET E STREHIMIT QË OFROHEN PËR AZILIN DHE UDHËTIMI	9
KUSHTET PËR MBËSHTETJEN	12
ANKIMI KUNDËR NJË VENDIMI PËR MBËSHTETJEN E AZILIT	14
SEKSIONI 2 ORGANIZATA TË RËNDËSISHME	15
ZYRA E BRENDSHME	15
OFRUESI I STREHIMIT TUAJ?	16
MIGRANT HELP	20
SEKSIONI 3 RAPORTIMI I SHQETËSIMEVE DHE ANKESAT	23
SEKSIONI 4 INFORMACIONI DHE STANDARDET PËR STREHIMIN	27
RREGULLAT DHE UDHËZIMET	29
SHËRBIMET QË MUND TË PRISNI TË KENI NË STREHIM	31
INSPEKTIMET E PRONËS	38
PËRDORIMI I STREHIMIT	39
RIPARIME DHE MIRËMBAJTJA	39
INFORMACION SHITESË PËR STREHIMIN	41
SEKSIONI 5 PAGESAT E PARAVE DHE MBËSHTETJES	45
SEKSIONI 6 DUKE VAZHDUAR MË TEJ PAS VENDIMIT NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR AZIL	48

Seksioni 1

Llojet e strehimit për azilin dhe udhëtimi



Koha e nevojshme për të përpunuar një kërkesë për azil mund të jetë e ndryshme. Kjo varet nga fakti se sa komplekse është çështja juaj dhe sa kohë duhet për të marrë provat dhe dokumentet.

Mbështetja për azilin, duke përfshirë strehimin, u ofrohet azilkërkuesve të cilët nuk kanë asnjë mënyrë tjetër për të mbështetur veten. Strehimi i azilit ofrohet mbi bazën "pa zgjedhje", pra ju nuk mund të zgjidhni se ku do të jetoni. Megjithatë, në rast se keni një arsye të veçantë për të cilën është e nevojshme të strehoheni në një zonë të caktuar, Zyra e Brendshme do ta marrë parasysh atë – udhëzimet për caktimin e strehimit mund të gjenden këtu: [Kërkesat për strehimin në azil: udhëzime për punonjësit e çështjeve – GOV.UK \(www.gov.uk\)](https://www.gov.uk/government/consultations/asylum-seekers-appeals) Ofruesi i strehimit duhet të sigurohet që strehimi të plotësojë çdo nevojë specifike që mund të keni.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të strehimit – **Strehimi Fillestar**, dhe **Strehim për Shpërndarje**.

1. Strehimi fillestar

Aktualisht ju jeni duke banuar në një Strehim Fillestar. Strehimi fillestar është një banesë ku ofrohet pension i plotë, gjysmë pension ose vetë-shërbim. Zakonisht është strehim i përbashkët në një mjedis të tipit bujtinë ose hotel, por mund të jetë diçka tjetër. Ky strehim është i destinuar për azilkërkuesit të cilët përndryshe do të mbeteshin të braktisur dhe kanë nevojë urgjente për strehim, para se të vendoset për kërkesat e tyre sipas Seksionit 95. Ai u ofrohet gjithashtu azilkërkuesve të cilëve u është dhënë mbështetja e parashikuar në Seksionin 95 (ose Seksionin 4) ndërkohë që janë në pritje për t'u zhvendosur në një strehim të përkohshëm për një afat më të gjatë (d.m.th. strehimin për shpërndarje). Azilkërkuesit të cilëve u është dhënë mbështetje nga Zyra e Brendshme mund të qëndrojnë në strehimin fillestar derisa të lirohet një vend në strehimin për shpërndarje.

Koha e qëndrimit të njerëzve në strehim fillestar para se të zhvendosen në një strehim për shpërndarje mund të jetë e ndryshme, megjithatë aktualisht afatet e pritjes janë të gjata. Ka një mungesë e banesave për strehim në nivel vendor për të gjithë, për shkak të një rritjeje të konsiderueshme të njerëzve që vijnë në MB për të kërkuar mbrojtje, së bashku me nevojën për të përmbushur nevojat ekzistuese të atyre që tashmë janë në MB dhe që janë regjistruar në listat e pritjes për strehim për një periudhë tepër të gjatë. Kjo do të thotë që ju mund të qëndroni në Strehimin Fillestar për një periudhë të zgjatur, megjithatë, ofruesi juaj dhe Zyra e Brendshme do të sigurohen që nevojat tuaja të plotësohen gjatë kësaj kohe. Në rast se mendoni

se nevojat tuaja nuk po plotësohen, ju duhet të kërkonti në lidhje me to tek Migrant Help për të shqyrtuar se si mund të bëhen ndryshime në strehimin tuaj, duke përfshirë mundësinë e përshpejtimit të procesit të zhvendosjes në strehim afatgjatë nëse nevojat mund të provohen dhe janë të përshtatshme.

2. Strehimi për shpërndarje

Strehimi për shpërndarje është strehim i përkohshëm për një afat më të gjatë i cili menaxhohet nga ofruesit e strehimit për llogari të Zyrës së Brendshme. Normalisht ju do të qëndroni në strehimin për shpërndarje derisa kërkesa juaj për azil të jetë përcaktuar plotësisht. Nuk është gjithmonë e mundur të qëndroni në të njëjtën pronë.



3. Vazhdimi pas vendimit në lidhje me kërkesën për azil

Kur kërkesa juaj për azil (përfshirë çdo ankim) të jetë përcaktuar plotësisht, ju duhet të largoheni nga strehimin e azilit dhe mbështetja juaj nga Zyra e Brendshme do të ndërpritet. Në rast se ju jepet leje qëndrimi, ju do të keni të drejtë të punoni, të përdorni fondet publike, të kërkonti strehim dhe të merrni ndihmë në lidhje me të në të njëjtën mënyrë si banorët e tjerë në MB. Kini parasysh se, për shkak se ka një mungesë strehimi në MB, mund të duhet kohë për të gjetur një strehim për ju. Edhe pse Autoriteti Vendor do t'ju japë informacion ose këshilla, ju duhet ta gjeni vetë strehimin tuaj privat. Këshillat dhe udhëzimet do të ofrohen si pjesë e takimit tuaj 'Vazhdimi' [Move-On] me Migrant Help ose mund të merren duke kontaktuar Autoritetin tuaj Vendor.



Megjithatë, nëse kërkesa juaj është e pasuksesshme dhe nuk ka pengesa të tjera të përkohshme, pritët që ju të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar. Migrant Help do t'ju ofrojë këshillim dhe udhëzime menjëherë pas marrjes së vendimit nga Zyra e Brendshme. Nëse dëshironi më shumë informacion mbi këtë opsion, Shërbimi I Kthimit Vullnetar është i disponueshëm nga e Hëna në të Premte, nga ora 9 e mëngjesit deri në 5 pasdite telefon: 0300 004 0202.

Pritshmëritë

Ju do të trajtoheni gjithmonë me respekt, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Po ashtu ne presim që ju ta trajtoni personelin dhe njerëzit me të cilët jetoni në të njëjtën mënyrë.

Ju duhet të raportoni çdo problem në lidhje me strehimin ose mbështetjen tuaj sapo t'i vini re ato duke kontaktuar me Migrant Help. **Kërkesa juaj për azil ose e drejta për mbështetje për azil nuk do të ndikohet nga raportimi i një shqetësimi ose problemi.**

Konfidencialiteti dhe ndarja e të dhënave

Zyra e Brendshme dhe ofruesit tanë do ta mbrojnë dhe ruajnë informacionin tuaj personal në mënyrë konfidenciale. Ekzistojnë disa rrethana kur është e nevojshme ta ndajmë informacionin që kemi për ju me agjenci të tjera. Këto rrethana përfshijnë:

- Ndarjen e informacionit me këshillat vendore për t'ju ndihmuar të merrni kujdes social, strehim të specializuar ose përshtatje pronës
- Ndarjen e informacionit me shërbimet shëndetësore për t'u siguruar se ofrohet kujdesi i duhur shëndetësor për nevojat tuaja të përgjithshme shëndetësore dhe për çdo gjendje mjekësore
- Ndarjen e informacionit për mbrojtjen ose "sigurinë" tuaj dhe familjes tuaj, veçanërisht të fëmijëve dhe të personave madhorë vulnerabël
- Ndarjen e informacionit përkatës me autoritetet arsimore në mënyrë që ata të mund të ofrojnë shërbimet e tyre
- Raportimin e çështjeve penale në polici dhe për t'ju ndihmuar të jeni të sigurt në komunitet
- Ndarjen e informacionit për të luftuar mashtrimin
- Zbulimin e informacionit në lidhje me procedimet gjyqësore

Çdo agjenci me të cilën ndahen të dhënat tuaja duhet gjithashtu të respektojë konfidencialitetin e informacionit tuaj. Ju mund t'i kërkonit Zyrës së Brendshme ose organizatave të tjera t'ju tregojnë informacionin që ata kanë për ju nëpërmjet "[kërkesë për përdorimin e informacionit](#)"



Kushtet për Mbështetjen

- **Ju duhet të zbatoni organizimin e udhëtimit që është bërë për ju.** Për shembull, zhvendosja në një pronë tjetër. Ju duhet të njoftoni Zyrën e Brendshme paraprakisht nëse ka ndonjë arsye pse nuk mundeni ta zbatoni organizimin e udhëtimit.
- **Ju duhet të jetoni në adresën e autorizuar.** Ju duhet të merrni leje nga Zyra e Brendshme duke kontaktuar Migrant Help nëse planifikoni të jeni larg për më shumë se 7 ditë pa ndërprerje. Ju nuk duhet të mungoni për më shumë se 14 ditë ose netë në çdo periudhë 6 mujore.
- **Ju duhet të zbatoni rregullat e strehimit në të cilin po qëndroni.** Ofruesi i strehimit do t'ju informojë për rregullat.
- **Ju nuk duhet të silleni në mënyrë të dhunshme apo të përdorni dhunë verbale apo fizike.** Sjellja e dhunshme mund të çojë në ndjekje penale, si dhe rrezikun e humbjes së strehimit dhe mbështetjes financiare.
- **Ju duhet të keni rregullisht akses ndaj mbështetjes tuaj financiare.** Pasi t'ju jepet Mbështetje në bazë të Seksionit 95 / Seksionit 4, juve ju jepet një shumë javore për të mbuluar çdo shpenzim shtesë ndërkohë që qëndroni në Strehim Fillestar. Në Strehimin Fillestar, nevojat bazë të jetesës plotësohen nga ofruesi juaj i strehimit (d.m.th., ushqim, artikuj tualeti, produktet për fëmijë etj.). Nëse banoni në strehim me vetë-shërbim, juve do ju jepet një ndihmë javore për të blerë ushqim për të gatuar për veten tuaj, në vend që t'ju jepet ushqim.
- **Ju duhet t'u përgjigjeni kërkesave të Zyrës së Brendshme.** Këtu përfshihen kërkesat për:
 - informacion në lidhje me kërkesën tuaj për azil
 - informacion në lidhje me mbështetjen tuaj për azil dhe
 - paraqitjen juaj në çdo intervistë

Në rast se nuk i përmbaheni kushteve për mbështetjen tuaj, rrezikoni të humbisni mbështetjen tuaj.

Ndryshime në rrethanat tuaja

Duke qenë se ju jeni duke marrë strehim dhe mbështetje për azil, ju duhet të njoftoni menjëherë Zyrën e Brendshme nëse ndodh ndonjë ndryshim i rrethanave tuaja. Mënyra më e lehtë për ta bërë këtë është nëpërmjet Migrant Help. Në rast se nuk keni më nevojë për strehim, ju përsëri mund të merrni ndihmë financiare, por duhet të pyesni së pari (megjithatë kjo nuk vlen për ata që marrin mbështetje në bazë të Seksionit 4 ose Listës 10).

Ndryshimet e rrethanave për të cilat duhet të njoftoni Zyrën e Brendshme janë:

- Nëse merrni ose fitoni mundësi për të pasur para ose asete financiare
- Nëse filloni një punë (ju duhet të kontrolloni nëse keni leje për të punuar para se të filloni një punë)
- Nëse zhvendoseni në një adresë tjetër pa dijeninë e ofruesve tuaj, ose vendosni të jetoni me familjen, miqtë ose një partner
- Nëse martoheni, ndaheni, zgjidhni martesën ose krijoni një partneritet civil
- Nëse shtroheni në spital ose burgoseni
- Nëse ju (ose partnerja juaj) mbeteni shtatzënë ose keni një fëmijë
- Nëse ndonjë nga fëmijët tuaj e lë shkollën ose largohet nga shtëpia
- Nëse ndonjë anëtar tjetër i familjes bashkohet me ju në Mbretërinë e Bashkuar ose largohet nga Mbretëria e Bashkuar
- Nëse dikush tjetër bashkohet ose largohet nga shtëpia juaj
- Nëse ndryshoni emrin tuaj
- Nëse planifikoni të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar dhe të ktheheni në vendin tuaj

Në rast se nuk na tregoni për një ndryshim të rrethanave tuaja, ju mund:

- Të humbisni mbështetjen tuaj nga Zyra e Brendshme
- të duhet të ktheni çdo mbështetje që keni marrë, për të cilën nuk keni pasur të drejtë
- Të jeni fajtor për një vepër penale në bazë të Ligjit për Imigracionin dhe Azilin 1999

Ankimi kundër një vendimi për mbështetjen e azilit

Zakonisht ju mund të bëni një ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë (Mbështetje për Azilin) në rast se:

- Kërkesa juaj për mbështetje për azil dhe/ose strehim është refuzuar
- Ju keni marrë mbështetje për azil në bazë të seksionit 4 dhe ajo është ndërprerë
- Ju keni marrë mbështetje për azil në bazë të seksionit 95, dhe ajo është ndërprerë përpara se ajo mbështetje do të përfundonte për ndonjë arsye tjetër.

Ju do të merrni një letër nga Zyra e Brendshme nëse kërkesa juaj është refuzuar ose mbështetja juaj është ndaluar ku shpjegohet pse është marrë vendimi. Në letër do t'ju tregohet gjithashtu nëse mund të bëni një ankim dhe si ta bëni ankimin. Gjykata është e pavarur nga qeveria. Para se të marrë një vendim, gjyqtari i dëgjon të dyja palët në mosmarrëveshje. Në rast se mbështetja juaj është ndaluar dhe ju bëni një ankim kundër kësaj, mbështetja juaj zakonisht duhet të vazhdojë deri në datën e ankimit. Formularët e Ankimit gjenden në faqen www.gov.uk

Ju mund të merrni ndihmë dhe këshillim para se të bëni një ankim:

- Ju mund të kontaktoni Asylum Support Appeals Project (ASAP) për përfaqësim ligjor pa pagesë nëse keni një seancë dëgjimore përpara Gjykatës së Shkallës së Parë (Mbështetje për Azilin). www.asaproject.org
- Ju mund të kontaktoni Refugee Action <https://www.refugee-action.org.uk/our-services/increasing-justice-tackling-poverty/> (i cili vepron në rajone të caktuara në Angli) dhe Refugee Council [Këshillin e Refugjatëve] www.refugeecouncil.org.uk (Angli dhe Uells) për këshillim dhe mbështetje - ata mund të jenë në gjendje të gjejnë një organizatë tjetër që t'ju ndihmojë.
- Ju gjithashtu mund të merrni këshilla të tjera juridike, përfshirë këshillim nga një avokat. Për më shumë informacion vizitoni adresën www.gov.uk/find-a-legal-adviser

Më shumë informacion mund të gjeni në faqen www.gov.uk/appeal-first-tier-asylum-support-tribunal



Seksioni 2

Organizata të rëndësishme



Home Office

Zyra e Brendshme

Çfarë është Zyra e Brendshme?

Zyra e Brendshme luan një rol themelor në sigurinë dhe prosperitetin ekonomik të Mbretërisë së Bashkuar. Zyra e Brendshme është departamenti kryesor i qeverisë për imigracionin dhe pasaportat, politikën kundër drogës, krimin, zjarrin, kundër-terrorizmin dhe policinë. Sektori i Zyrës së Brendshme me të cilin do të merreni në mënyrë të drejtpërdrejt quhet Azili dhe Mbrojtja.

Çfarë mund të pres nga Zyra e Brendshme?

Kërkesa juaj për azil do të përpunohet dhe vlerësohet nga ekipet e Departamentit të "Shërbimit ndaj Klientit" për Operacionet e Azilit. Ky është një departament i Zyrës së Brendshme. Suksesi i aplikimit tuaj për azil do të varet nga vlerësimi i tyre dhe ju do të kontaktoheni për t'ju informuar për vendimin që është marrë.

Ekipet për Mbështetjen e Azilit në Zyrën e Brendshme janë përgjegjëse për të vendosur se çfarë mbështetje duhet të merrni dhe për të mbikëqyrur ofruesit që japin këtë mbështetje. Ekipet e Mbështetjes për Azil gjithashtu do të sigurohen që shërbimet e ofruara nga ofruesit tanë të strehimit të përmbushin pritshmëritë e përcaktuara në këtë broshurë.

Çfarë pret Zyra e Brendshme nga unë?

Home Office [Zyra e Brendshme] pret që ju të respektoni të gjitha kushtet për mbështetjen tuaj dhe të na informoni për çdo ndryshim të rrethanave tuaja. Në rast se nuk e bëni këtë, ka të ngjarë që e drejta juaj për të vazhduar marrjen e ndihmës do të cenohet.

Mos injoroni asnjë letër që ju dërgohet nga Zyra e Brendshme pasi kjo mund të rezultojë në refuzimin ose ndërprerjen e mbështetjes tuaj. Në rast se nuk jeni të sigurt se çfarë do të thotë një letër, kontaktoni Migrant Help për këshillim dhe udhëzime.

Ju mund të merrni më shumë informacion rreth shërbimeve të ofruara nga qeveria duke vizituar faqen www.gov.uk

Ofruesi i strehimit tuaj?


Çfarë është ofruesi i strehimit?

Ofruesi i strehimit është një kompani që kontraktohet nga Zyra e Brendshme për të ofruar strehim për azilkërkuesit dhe për të mirëmbajtur strehimin. Ofruesit e strehimit ndryshojnë në varësi të vendndodhjes.

MEARS

**READY
HOMES**

serco



Çfarë mund të pres nga ofruesi i strehimit?

Shërbimet që ofrohen nga ofruesi i strehimit përfshijnë:

- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e banesës, mobilieve, pajisjeve dhe shërbimeve të pastra, të sigurta dhe të banueshme.
- Një prezantim të strehimit pas mbërritjes, i cili përfshin informacion në lidhje me shërbimet që janë në dispozicionin tuaj
- Ofrimin e një shërbimi ushqimor në banesë, ku përfshihen tre vakte në ditë dhe përdorimi i artikujve bazë të higjienës personale dhe artikuj tualeti (ose, në mënyrë alternative, në rastin e personave që qëndrojnë në strehim me vetë-shërbim, para të gatshme për të mbuluar koston e këtyre artikujve në mënyrë që të plotësoni nevoja tuaja Vini Re: *personat që marrin mbështetje në bazë të Seksionit 4 nuk kanë të drejtë për ndihmë në para dhe, nëse është rasti, do të marrin para të kredituara në një kartë Aspen*). Gratë shtatzëna dhe foshnjat kanë të drejtë për përfitime shtesë për të mbuluar nevojat e tyre ushqimore dhe të jetesës (përdorimi i pelenave, formulave, qumësht, më shumë furnizim me ushqime, pajisje për sterilizimin e shisheve të bebeve, etj.), ndërkohë që janë në strehim me ushqim të plotë ose me mëngjes dhe darkë. Familjet me foshnja të vogla dhe gratë shtatzëna mund të aplikojnë për një Grant pas Lindjes ndërkohë që janë në Strehimin Fillestar. Për gratë shtatzëna dhe nënat e reja që qëndrojnë në strehim me vetë-shërbim, do të jepet një shtesë për mbështetjen financiare javore që marrin.
- Promovimin e mirëqenies tuaj, duke ju referuar në agjencitë përkatëse kur kjo mund t'ju ndihmojë
- Ofrimin e shërbimeve të përkthimit me gojë dhe me shkrim kur është e nevojshme të komunikohet me ju
- Shpjegimin e proceseve për opinionet dhe ankesat dhe zgjidhjen e çdo ankese brenda 5 ditë pune kurdoherë që është e mundur
- Menaxhimin e sjelljeve anti-sociale dhe të dhunshme që mund të ndodhin në strehim
- T'ju tregojë se ku ndodhet zyra më e afërt e Mjekut të Përgjithshëm ose t'ju ndihmojë të regjistroheni tek Mjeku i Përgjithshëm nëse keni një sëmundje të mëparshme (përveç nëse një Infermiere Praktikuere është e disponueshme në vend).
- ndihmën për të përdorur shërbimet e kujdesit shëndetësor nëse keni nevojë për të në momentin e mbërritjes ose gjatë qëndrimit tuaj në strehim (kjo mund të organizohet nëpërmjet Menaxherëve të Mirëqenies për Banorët, Ekipet e Mbrojtjes ose Menaxherët e Strehimit)
- Ofrimi për Përdoruesit e Shërbimit në marrin mbështetje sipas Seksionit 4 dhe Seksionit 98 dhe Listës 10 i ndihmës për udhëtimin - ose duke iu siguruar transport ose duke iu dhënë bileta për transportin publik – për takimet me mjekun, dentistin dhe në spital, takime para lindjes ose pas lindjes, ose për udhëtime për të regjistruar lindjet ose vdekjet e anëtarëve të familjes. *Ju lutemi vini re se duhet të përdorni shërbime lokale aty pranë kurdo që të jetë e mundur dhe duhet të jepni evidenca për*

çdo takim (p.sh., një letër takimi) dhe t'i jepni sa më herët njoftim ofruesit tuaj për t'u siguruar që ajo mund të organizohet në kohën e duhur. Për çdo shqetësim që përfshin transportin, ju lutemi kontaktoni me Migrant Help.

Nëse keni ndonjë problem që lidhet me strehimin gjatë qëndrimit tuaj në strehimin fillestar, ju duhet t'i ngrini këto probleme nëpërmjet Migrant Help me telefon në numrin **0808 8010 503**, nëpërmjet **webchat** në adresën https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch ose nëpërmjet **Ngrini një Problem** (<https://ellis.custhelp.com/app/ask/session>)


Telefononi pa pagesë në linjën e tyre të ndihmës në numrin: 0808 8010503.

Më pas ata do ta ngrenë shqetësimin me ofruesin e strehimit tuaj për llogarinë tuaj. Për më shumë informacion, shihni "**Raportimi i Shqetësimeve dhe Ankesave**".

Çfarë pret ofruesi i strehimit nga mua?

Ju duhet ta trajtoni strehimin me respekt. Këtu përfshihet mbajtja e strehimit pastër dhe të tregoni kujdes për të mos dëmtuar instalimet dhe pajisjet në pronë.

Ju gjithashtu duhet të tregoni respekt për këdo me të cilin ndani strehimin dhe për personelin që takoni.



Migrant Help

Çfarë është Migrant Help?

Migrant Help është një organizatë bamirëse e cila ofron një shërbim kombëtar i quajtur Këshillim, Raportimi i Shqetësimeve dhe Kualifikimi (AIRE), e pavarur nga Zyra e Brendshme. Migrant Help mund t'ju ofrojë këshillim dhe udhëzime të pavarura në lidhje me procesin e azilit dhe të drejtat tuaja. Ata gjithashtu mund t'ju referojnë tek shërbime të tjera që janë të disponueshme në Mbretërinë e Bashkuar.



Çfarë mund të pres nga Migrant Help?

Migrant Help do t'ju ndihmojë të kërkonti mbështetje financiare, strehim, këshillim juridik dhe shërbime të tjera për të cilat keni të drejtë me ligj. Ata do t'ju japin informacion për t'ju ndihmuar të kuptoni procesin e azilit, të drejtat tuaja për mbështetje dhe si mund të përdorni shërbime të tjera bazë (përfshirë kujdesin shëndetësor dhe këshillim juridik) para intervistës tuaj për azil. Ju do të keni mundësi të përdorni një përkthyes nëse kërkohet, dhe kjo duhet të kërkohet në fillim të telefonatës.

Linja e ndihmës pa pagesë e Migrant Help mund t'ju ofrojë këshillim në gjuhën tuaj. Temat për të cilat ata mund të ndihmojnë përfshijnë:

- Si të kërkonti azil
- Mbështetje financiare
- Si të gjeni një përfaqësim ligjor
- Proceset e azilit
- Si të merrni kujdes shëndetësor
- Mbështetje për strehimin

Ju mund të ngrini një ankesë për Zyrën e Brendshme nëpërmjet Migrant Help; megjithatë, kjo duhet të jetë në lidhje me strehimin ose mbështetjen për azil. Së pari ju duhet të ngrini çdo shqetësim nëpërmjet Migrant Help, përpara se të vazhdoni me çdo formë tjetër veprimi ose ankesë.

Ankesat në lidhje me Kërkesat për Azil ose Ankimet kundër kërkesës për azil nuk do të pranohen dhe ju duhet të ndiqni udhëzimet e dhëna në letrat përkatëse për të bërë progres me to.

Lejet Biometrike për Qëndrimin (BRPs), gabimet në Kartën e Regjistrimit të Aplikimit (ARC) dhe shqetësimet në lidhje me Lejen e Punës (PTW) **nuk duhet të** të ngrihen me Migrant Help. Në vend të tyre, ju mund t'i raportoni problemet me këto shërbime në internet në adresën:

- BRP - [Lejet biometrike për qëndrimin \(BRPs\): Si të merrni BRP-në tuaj nëse keni aplikuar nga Mbretëria e Bashkuar - GOV.UK \(www.gov.uk\)](#)
- ARC - [Kartën e Regjistrimit të Aplikimit \(ARC\) - GOV.UK \(www.gov.uk\)](#)
<https://www.gov.uk/government/publications/application-registration-card-arc>
- PTW - [Leja e punës dhe veprimtari vullnetare për azilkërkuesit \(e disponueshme\) - GOV.UK \(www.gov.uk\)](#)

-

Linja e tyre e ndihmës mbështet një numër të madh azilkërkuesish dhe linjat telefonike mund të jenë të zëna, gjë që mund të rezultojë në një vonesë në përgjigjen e telefonatës tuaj. Ju lutemi kini durim dhe ne do t'i përgjigjemi telefonatës tuaj sa më shpejt që të jetë e mundur. Kur është e mundur, ju lutemi merrni parasysh përdorimin e **Webchat** dhe **Ngrini një Shqetësim** për pyetje jo urgjente.

Migrant Help gjithashtu mund t'ju ndihmojë të plotësoni formularin e aplikimit për mbështetje financiare dhe strehimin (mbështetje për azil) (ASF1) ose një kërkesë për mbështetje shtesë për azil (ASF2). Ata gjithashtu do t'ju ndihmojnë në rast se keni nevojë t'i tregoni Zyrës së Brendshme për një ndryshim të rrethanave tuaja.

Migrant Help nuk mund t'ju ofrojë këshillim juridik ose përfaqësim ligjor. Ata mund t'ju japin informacion se si të kërkonti dhe merrni shërbime juridike. Ju gjithashtu mund të kërkonti për një këshillues juridik në adresën www.gov.uk/find-a-legal-adviser

Ju gjithashtu mund të kontaktoni Migrant Help nëse dëshironi të bëni një ankesë për ofruesin e strehimit, ofruesin e pagesave, Zyrën e Brendshme ose vetë Migrant Help. Nëse keni ndonjë problem me strehimin tuaj, ju gjithashtu duhet të kontaktoni Migrant Help. Më shumë informacion se si ta bëni këtë mund të gjendet në '[Raportimi i Shqetësimeve dhe Ankesat](#).' Ankesat për strehim nuk kanë aspak ndikim në rezultatin e kërkesës suaj për azil ose në kualifikimin tuaj për të marrë mbështetje dhe strehim.

Çfarë pret Migrant Help nga mua?

- Kur të kontaktoni Migrant Help, ju lutemi të keni gati të gjithë numrat e referencës të dokumenteve që ju janë dhënë nga Zyra e Brendshme.
- Paraqituni në çdo takim që ju është caktuar. Merrni çdo informacion ose dokument që lidhet me kërkesën tuaj.
- Flisni vetë me Migrant Help sa herë që është e mundur në vend që t'u kërkon miqve ose familjes të flasin me Migrant Help në emrin tuaj. Mos u shqetësoni në rast se nuk flisni anglisht, përkthyesit do të jenë në dispozicion.
- Bëni shënime përpara se të telefononi Migrant Help ose të paraqiteni në një takim, në mënyrë që të gjitha pyetjet tuaja të trajtohen në mënyrë efikase.
- Përgjigjuni pyetjeve që ju bëjnë këshilluesit e tyre në mënyrë sa më të plotë që të jetë e mundur. Ata janë të trajnuar për pyetjet që duhet të bëjnë për t'ju ndihmuar për kërkesën tuaj.
- Mbajini ata të përditësuar për çdo ndryshim të të dhënave të kontaktit si për shembull numrin e telefonit dhe adresën e emailit.
- Migrant Help do të konfirmojë gjithmonë identitetin tuaj dhe asnjëherë nuk do t'ua zbulojë informacionin personal palëve të tjera. Në rast se dëshironi që një individ ose organizatë tjetër të veprojnë në emrin tuaj, ju duhet të firmosni një **Autorizim**, ose të jepni **pëlqimin tuaj me gojë** kur flisni me Migrant Help, për ta bërë më të lehtë këtë. Për më shumë këshilla se si ta bëni këtë, kontaktoni Migrant Help.
- Migrant Help nuk do të pranojë sjellje abuzive, kërcënuese ose agresive. Personeli i tyre do t'ju trajtojë me mirësjellje dhe respekt. Ju lutemi silluni ndaj tyre në të njëjtën mënyrë.

Kontakti me Migrant Help

Ju mund ta kontaktoni Migrant Help nëpërmjet:

Webchat: https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch

Ngrini një Shqetësim nëpërmjet faqes së tyre të internetit:
(<https://ellis.custhelp.com/app/ask/session>)

Telefononi **linjën e ndihmës pa pagesë në numrin: 0808 8010503**.

Këto shërbime janë në dispozicion 24 orë në ditë, 7 ditë në javë dhe ofrojnë shërbime të plota përkthimi. Ju lutemi vini re: nëse banoni në Napier, personeli i Migrant Help është i disponueshëm aty.

Më shumë informacion dhe këshilla të përkthyera në 10 gjuhë mund të gjenden në faqen e internetit të Migrant Help **www.migranthelpuk.org**.



Seksioni 3

Raportimi i shqetësimeve dhe ankesat



Në rast se keni ndonjë shqetësim në lidhje me strehimin ose mbështetjen tuaj, ose dëshironi të bëni një ankesë kundër ndonjë prej organizatave në këtë paketë, ju duhet ta bëni këtë nëpërmjet Migrant Help sa më shpejt që të mundeni.

Ju lutemi vini re se për përdoruesit e shërbimit që janë strehuar në bordin e anijeve (maune), çështjet e mirëmbajtjes duhet të ngrihen drejtpërdrejt me personelin e anijes dhe jo nëpërmjet Migrant Help.

Ankesat ose çështjet e ngritura nuk do të ndikojnë në kërkesën tuaj për azil ose të drejtën tuaj për vazhdimin e marrjes së mbështetjes. Ju duhet të jeni të sigurt se të gjitha ankesat e marra do të trajtohen seriozisht dhe do të hetohen nga organizatat përkatëse. Defektet e raportuara do të trajtohen në një afat kohor të caktuar në varësi të kategorisë së defektit. Shembuj mund të gjenden në pjesën 'Riparime dhe Mirëmbajtje.' Nëse defekti nuk rregullohet brenda këtij afati, ju duhet të kontaktoni sërish **Migrant Help** dhe ata do ta përshkallëzojnë problemin.

Është e rëndësishme që nëse doni të bëni një ankesë për ndonjë aspekt që lidhet me strehimin ose mbështetjen tuaj, ta bëni atë sa më shpejt të jetë e mundur. Komentet dhe ankesat janë të mirëpritura pasi ato ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve që ofrohen. Procesi i ankesave duhet të ndiqet përpara se të ndërmerret ndonjë veprim tjetër formal në lidhje me një problem në mënyrë që ofruesi i strehimit dhe/ose Zyra e Brendshme të kenë mundësi të hetojnë shqetësimet tuaja.

Ju duhet të kontaktoni Migrant Help në lidhje me:

Shqetësimet për mirëmbajtjen – për të raportuar probleme në lidhje me strehimin e azilit. Ata do të flasin me ofruesin e strehimit në emrin tuaj për t'i adresuar këto probleme (shihni "Riparimet dhe mirëmbajtja" në faqen 24 më poshtë).

Kërkesat për ndihmë – në rast se mendoni se ekziston rrezik për shëndetin dhe mirëqenien tuaj ose të familjes tuaj. Kjo mund të bëhet për të raportuar dyshimet për neglizhencë ndaj fëmijës, dhunë në familje, ngacmim ose shfrytëzim seksual, sjellje antisociale, braktisje ose mungesë strehimi, ose dyshime për ekstremizëm ose radikalizëm.

Migrant Help do t'ia kalojë kërkesën ose raportin Ofruesit tuaj, i cili më pas është përgjegjës për ndërmarrjen e çdo veprimi që e konsideron të nevojshëm për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien tuaj, përfshirë informimin e Zyrës së Brendshme dhe, kur është e nevojshme, Policinë.

Ankesat – nëse dëshironi të bëni një ankesë në lidhje me shërbimet e ofruara nga Migrant Help, ofruesi juaj i strehimit, ofruesi i pagesave të mbështetjes së azilit ose Zyra e Brendshme, ju duhet të kontaktoni Migrant Help dhe të kërkonit të bëni një ankesë për hetim dhe përgjigje përpara se të ndërmerrni ndonjë veprim formal të mëtejshëm.

Komente – për të përmirësuar vazhdimisht mbështetjen që është në dispozicionin tuaj gjatë gjithë rrugëtimit të kërkesës për azil. Ju mund t'u tregoni atyre për përvojën tuaj me shërbimet e ofruara nga Migrant Help, ofruesi i strehimit, ofruesi i pagesave dhe mbështetjes për azil ose Zyra e Brendshme. Ata do t'ia kalojnë komentet tuaja organizatës së duhur.

Për ta bërë këtë, telefononi në numrin **0808 8010 503**, përdorni **webchat në adresën https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch** ose Ngrini një Shqetësim në adresën <https://ellis.custhelp.com/app/ask>.

Përdorimi i telefonit duhet të vihet në dispozicion për ju brenda strehimit tuaj. Nëse e keni të vështirë ta gjeni një të tillë, pyesni një anëtar të personelit të strehimit. Ju gjithashtu mund të përdorni një kompjuter dhe internetin në bibliotekën tuaj lokale.

Shqetësimi do të ngrihet drejtpërdrejt me Migrant Help ose ata do të sigurohen që ofruesi përkatës të merret me të. Këshilluesit e tyre do t'ju japin një afat kohor se sa shpejt mund të prisni që problemi të adresohet.

Megjithëse mund t'i drejtoheni personelit të strehimit për çdo pyetje që lidhet drejtpërdrejt me përvojën tuaj në strehim (p.sh. ushqimi, përdorimi i artikujve të tualetit dhe artikujve bazë, informacion rreth objekteve si lavanderia etj.), ju lutemi mos ngrini shqetësime që lidhen me mirëmbajtjen ose ndihmën financiare në këtë mënyrë (përveç nëse është një shqetësim që lidhet me mirëmbajtjen e anijes). Në vend të kësaj, ju lutemi telefononi Migrant Help për të raportuar zyrtarisht këto probleme. Kjo bën të mundur që çështja juaj të regjistrohet dhe monitorohet zyrtarisht për një zgjidhje efektive.

Aspen dhe Çështjet që lidhen me Pagesat

Nëse keni nevojë për ndihmë në lidhje me kartën tuaj Aspen, ju mund të kontaktoni ofruesin e mbështetjes **PFS me telefon në numrin 0800 246 1327**. Pasi të bëhet lidhja, mbështetja mund të sigurohet me tre opsionet e mëposhtme:

- Zbulimi i PIN-it
- Kontrolli i bilancit
- E humbur dhe e vjedhur - bllokimi i kartës

Ky shërbim është i disponueshëm në 10 gjuhë, si dhe në Anglisht. Aktualisht janë në dispozicion gjuhët e mëposhtme: Shqip, Amharik, Arabisht, Kineze, Persiane, Kurde, Pashto, Punjabi, Tigrinya dhe Urdu.

Nëse keni ndonjë shqetësim tjetër në lidhje me Kartën tuaj Aspen ose Pagesën për Azilin, ju duhet të kontaktoni Migrant Help i cili do ta ngrejë problemin me palën përkatëse në emrin tuaj.

Ankesa për ofruesit

Ankesat në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i strehimit, ofruesi i pagesave për mbështetjen ose Migrant Help duhet të bëhen nëpërmjet Migrant Help duke telefonuar në numrin **0808 8010 503**, ose ndryshe nëpërmjet Webchat: https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch ose nëpërmjet Ngrini një Problem në adresën: <https://ellis.custhelp.com/app/ask>

Pasi të marrë ankesën, ofruesi përkatës do të synojë ta zgjidhë dhe t'i përgjigjet ankesës suaj brenda 5 ditë pune. Nëse nuk mund të zgjidhet nga ofruesi përkatës, ose nuk jeni të kënaqur me përgjigjen, Migrant Help do ta dërgojë ankesën tuaj tek Zyra e Brendshme.

Pasi ankesa kundër një ofruesi i është dërguar Zyrës së Brendshme, departamenti do të synojë të japë përgjigje brenda 20 ditë e pune. Në rast se jeni të pakënaqur me përgjigjen tonë, ju mund ta përshkallëzoni ankesën tuaj tek Ekzaminuesi i Pavarur i Ankesave (IEC) brenda tre muajve nga data e përgjigjes duke dërguar: e-mail në adresën iec@homeoffice.gov.uk ose duke shkruar në adresën PO BOX 6147, SHEFFIELD, S2 9JD. Megjithatë, ju lutemi vini re se megjithëse IEC mund ta shqyrtojë se si është trajtuar ankesa juaj, ajo nuk mund të trajtojë ankesat për shërbimet për të cilat nuk ka kërkesë kontraktuale.

Nëse vendosni ta përshkallëzoni ankesën tuaj tek IEC, ju duhet t'u jepni atyre një kopje të përgjigjes së Zyrës së Brendshme ndaj ankesës tuaj fillestare së bashku me çdo provë që keni dhënë.

Informacione të mëtejshme rreth Ekzaminuesit të Pavarur të Ankesave dhe udhëzimet për të bërë një ankesë tek IEC mund të gjenden në faqen e internetit të Gov.uk në adresën <https://www.gov.uk/guidance/make-a-complaint-to-the-independent-examiner-of-complaints>

Nëse jeni ende të pakënaqur me përgjigjen e IEC ndaj ankesës tuaj, kjo mund të ngrihet me Avokatin e Popullit Parlamentar dhe Shërbimit Shëndetësor. Avokati i Popullit merr vendime përfundimtare për ankesat që nuk janë zgjidhur nga NHS, departamentet qeveritare dhe disa organizata të tjera publike. Shërbimi i tyre është falas për të gjithë. Ju lutemi vini re, për të bërë një ankesë tek Avokati i Popullit, ju duhet të kontaktoni Deputetin tuaj të zonës, i cili mund ta referojë këtë në emrin tuaj. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen www.ombudsman.org.uk ose telefononi në numrin 0345 015 4033.

Ankesat në lidhje me mbështetjen tuaj

Pasi ankesa të depozitohet tek Migrant Help, në lidhje me Zyrën e Brendshme, ajo do të ndahet me ekipin përkatës për hetim dhe përgjigje brenda 20 ditë pune. Nëse nuk jeni ende të kënaqur me përgjigjen e departamentit, ju keni të drejtë t'ia referoni çështjen Ekipit Qendror të Ankesave (CCT) për shqyrtim. Detajet se si ta bëni këtë do t'ju jepen së bashku me përgjigjen.

Në çfarë mënyrë tjetër mund të bëj një ankesë tek Zyra e Brendshme?

Ju mund të bëni një ankesë direkt tek Zyra e Brendshme në rast se:

- Ju tashmë keni bërë një ankesë nëpërmjet Migrant Help, keni raportuar tek Migrant Help për pakënaqësinë tuaj për përgjigjen dhe ende nuk jeni të kënaqur me rezultatin, ose
- Ju keni një ankesë që mendoni se nuk është e përshtatshme për t'u zgjidhur nga Migrant Help

Në rast se Zyra e Brendshme merr një ankesë e cila duhet t'i ishte drejtuar Migrant Help, ajo do t'i dërgohet Migrant Help.

Për të bërë një ankesë tek Zyra e Brendshme:

Dërgoni me email ankesën tuaj në adresën complaints@homeoffice.gov.uk ose na shkruani në adresën:

Complaints Allocation Hub
Customer Correspondence Hub
7th Floor Lunar House
40 Wellesley Road Croydon
CR9 2BY

Seksioni 4

Informacion dhe standardet për strehimin



Ofruesit tanë kanë disa lloje strehimi. Ju mund të qëndroni në:

Hotel

Ky lloj strehimi zakonisht përdoret nga përdorues të vetëm të shërbimit dhe familje dhe ofrohet me ushqim. Strehimi ofrohet në baza pa të drejtë zgjedhjeje dhe përdoruesit e vetëm të shërbimit mund të kenë nevojë të ndajnë një dhomë. Inkurajohet ndarja e dhomës me miqtë ose familjen në rast se ata janë të së njëjtës gjini. Do të bëhet çdo përpjekje për të siguruar që përdoruesit e shërbimit të flasin të njëjtën gjuhë me personin me të cilin po ndajnë një dhomë. Aty ku ka hapësira të përbashkëta, dot të sigurohet përdorimi i tualetit sipas gjinisë.

Strehimi Fillestar

Ky lloj strehimi zakonisht përdoret nga përdorues të vetëm të shërbimit dhe familje dhe ofrohet me ushqim (d.m.th. ofrohen 3 vakte në ditë). Ka mjedise për larje specifike sipas gjinisë dhe mund të ketë dhoma të përbashkëta gjumi që marrin parasysh rregullat e ndarjes së Zyrës së Brendshme.

Të tjera (përfshirë anijet dhe mjediset më të mëdha të jetesës së përbashkët si Sallat e Banimit ose Ish-Bazat Ushtarake)

Njësitë në shkallë të gjerë – të tilla si Bazat Ushtarake Wethersfield dhe Scampton - ofrojnë strehim bazë dhe funksional me shërbime gjithëpërfshirëse të kujdesit shëndetësor në vend për të zvogëluar presionin mbi shërbimet lokale të GP dhe NHS, shërbime për ushqim në vend dhe me roje 24/7. Në këto vende do të strehohen vetëm azilkërkues meshkuj, beqarë dhe në moshë madhore të cilët nuk janë të ndaluar.

Në strehimin brenda anijeve, të gjitha kabinat kanë dritare, ajër të kondicionuar, njësi ngrohjeje, hapësirë magazinimi dhe anija ka lidhje me WIFI. Të gjitha dhomat kanë mjediset e banjove dhe ka hapësira të shumta të përbashkëta, një kantinë dhe lavanderi. Transporti drejt Portit dhe në kthim ju ofrohet.

Rregullat dhe udhëzimet

Për t'ju ndihmuar të sistemoheni në strehimin në të cilin jeni duke qëndruar dhe për të reduktuar në minimum shqetësimet ndaj të tjerëve, ju duhet:

Të bëni:

- Të kini kujdes për shëndetin dhe sigurinë tuaj nga rreziqet dhe t'i trajtoni të gjitha pajisjet me kujdes
- Të trajtoni me respekt të gjithë banorët që banojnë aty, pavarësisht nga seksi, gjinia, identiteti gjinor, raca, përkatësia etnike, gjuha, kombësia, feja, paaftësitë, orientimi seksual.
- Të silleni në mënyrë të sjellshme dhe të respektueshme ndaj banorëve të tjerë dhe personelit
- Të raportoni shqetësimet që lidhen me riparimet ose mirëmbajtjen tek Migrant Help sapo t'i vini re ato
- Nëse ndani ndarjet e gjumit, të jetesës ose të shërbimeve, ruajeni në mënyrë të sigurt çdo send personal
- Lëshoni ujin për të pastruar tualetin pas çdo përdorimi, por mos hidhni sende të tilla si peceta për fëmijë ose produkte sanitare
- Pastroni mjediset e strehimit rregullisht, ose aty ku ofrohen shërbimet e pastrimit, dyshemetë dhe sipërfaqet për ta lehtësuar atë
- Hapini dritaret rregullisht për të parandaluar shfaqjen e mykut ose lagështirës
- Sigurohuni që dyert të jenë të mbyllura, dhe dritaret të jenë të mbyllura gjatë natës dhe kur ndodheni jashtë



Mos:

- Bëni shumë zhurmë, veçanërisht ndërmjet orës 23:00 dhe 08:00
- Pini duhan brenda banesës
- Mbani kafshë shtëpiake ose kafshë në pronë
- Lejoni vizitorët të qëndrojnë gjatë natës
- Dëmtoni pronën
- Merrni ushqim nga zonat e caktuara të ngrënies në dhomën tuaj (*përveç rastit kur strehimi juaj thotë se kjo pranohet*)
- Kryeni asnjë ndryshim ose riparim të pronës ose instalimeve elektrike
- Çaktivizoni alarmet e tymit



- Mbani ose përdorni drogë të paautorizuar në mjedise
- Shqetësoni banorët e tjerë në mënyrë të qëllimshme
- Përdorni sjellje ose gjuhë të papërshtatshme ndaj askujt
- Hapni letrat e personave të tjerë

Shërbimet që mund të prisni të keni në strehim

Artikujt e mëposhtëm duhet t'ju sigurohen brenda strehimit fillestar.

Nëse diçka që është në këto lista nuk ju është dhënë, ose ndonjë artikull nga inventari mungon ose prishet, ju lutemi kontaktoni Migrant Help.



Hapësirat e larjes

Një banjë brenda dhomës, ose të paktën mundësi për të përdorur 1 banjo sipas gjinisë për 5 përdorues të shërbimit, e cila përbëhet nga:

- Vaskë dhe/ose dush duke përfshirë një mbulesë të papërshkueshme nga uji nëse është e përshtatshme (p.sh., perde dushi)
- Lavaman
- Tualet

Tavolinë ngrënie

Në strehimet me ushqim:

- Mundësi për të pasur të paktën në **3 vakte në ditë** (mëngjes, drekë dhe darkë), me një zgjedhje të paktën një zgjedhje të nxehtë, një zgjedhje të ftohtë dhe një opsion vegjetarian në çdo vakt së bashku me shërbimin e një **pijeje** (*mundësia për të pasur ujë të pijshëm duhet të jetë në dispozicion në çdo kohë dhe mund të përfshijë disponueshmërinë e ujit të rubinetit, i cili trajtohet dhe është i sigurt për t'u konsumuar në MB*)
- Ju lutemi vini re se kur përgatitet ushqim për një numër të madh njerëzish, është e vështirë të kënaqen të gjitha shijet dhe preferencat. Nëse dëshironi të jepni komente për ofertën e ushqimit për të ndikuar në krijimin e menyve në vendin e strehimit tuaj, ju lutemi bëjeni këtë përmes Migrant Help ose informoni personelin që gjendet aty
- Një shërbim ushqimi për foshnjat dhe fëmijët e vegjël me ushqime të përshtatshme, me ushqime ose vakte shtesë siç kërkohet për të përmbushur nevojat ushqyese të fëmijëve dhe për gratë shtatzëna
- Opsionet që plotësojnë kërkesat e veçanta dietike, kulturore apo fetare dhe për ushqimet shtesë për përdoruesit e shërbimit për të cilët tre vakte ditore mund të jenë të pamjaftueshme. Ju lutemi vini re se është e nevojshme që të jepni prova nga një Mjek i Përgjithshëm ose një profesionist i kujdesit shëndetësor në të cilat përshkruhen me hollësi çdo kërkesë specifike mjekësore për ushqimin, në mënyrë që ofruesi juaj të mund t'i përshtatë ato siç duhet.

- Kur ju nuk do të jeni të disponueshëm për shërbimin e planifikuar të drekës (p. sh., për shkak të një pune vullnetare, shkollës, takimeve mjekësore) ju lutemi informoni ofruesin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të bëhen organizimet alternative



Në strehimet ku gatvani vetë:

- Mundësi për të përdorur të paktën 1 kuzhinë për çdo 5 persona duke përfshirë mundësinë për të përdorur:
 - ✓ Enët e gatimit dhe enët e ngrënies
 - ✓ Frigorifer dhe ngrirës, Sobë ose furrë dhe pllakë ngrohjeje
 - ✓ Hapësirë për përgatitjen e ushqimit me banakë pune higjienikë
 - ✓ Lavaman
 - ✓ Produkte pastrimi
- Pagesa javore në para për të mundësuar blerjen e artikujve për të përmbushur nevojat tuaja bazë të jetesës siç është ushqimi. Ju lutemi vini re se pagesat në para nuk u ofrohen atyre që marrin mbështetje sipas Seksionit 4(2) ose Listës 10 dhe këta përdorues të shërbimit do të marrin një Kartë Aspen e cila mbushet me vlerën e mbështetjes që ju takon çdo javë.

Çdo çështje që lidhet me shqetësimet për shëndetin dhe sigurinë ndaj rreziqeve duhet të ngrihet me Migrant Help që në rastin e parë në mënyrë që ofruesi juaj të njoftohet dhe të fillojë një hetim.

Dhomat e gjumit

Të gjitha strehimet fillestare:

- Shtretër të përshtatshëm për personat që strehohen (krevate teke ose dopio) dhe krevate për bebe dhe fëmijë të vegjël
- 1 gardërobë ose formë tjetër për varjen e rrobave për dhomë ose 1 për person të vetëm kur dhoma ndahet nga persona madhorë që nuk kanë lidhje
- 1 sirtar ose formë tjetër për mbajtjen e rrobave për dhomë ose 1 për person të vetëm kur dhoma ndahet nga persona madhorë që nuk kanë lidhje



- Perde ose grila të instaluar në dritare

Hapësirat e banimit dhe ato komunale

Në strehimet me ushqim:

- Mjedise të përshtatshme për ngrënie dhe ndenjëse të buta për të plotësuar kërkesat për numrin e përdoruesve të shërbimit që janë strehuar

Në strehimet ku gatuhet vetë:

- Mundësia për të përdorur një tavolinë, 1 karrige ngrënie për person dhe 1 kolltuk për person

Në të gjitha strehimet fillestare:

- Mundësi e arsyeshme për të përdorur tavolina dhe karrige të rehatshme për aktivitete rekreative



Mjediset

Në të gjitha strehimet fillestare:



- Mundësi e arsyeshme për të pasur ujë të pijshëm të freskët (ju lutemi vini re se uji i rubinetit është i sigurt për t'u pirë në MB dhe nuk ka nevojë që t'ju sigurohet uji në shishe)
- Mundësi e arsyeshme për të përdorur mjediset e lavanderisë (p. sh., shërbimin e lavanderisë ose lavatriçe)
- Mundësia për të pasur një varëse për tharjen e rrobave (sipas kërkesës)
- Tavolinë për hekurosje dhe hekur për rrobat
- Pajisje për kujdesin e fëmijëve, nëse është e aplikueshme, duke përfshirë krevat për fëmijë dhe karrige të larta dhe pajisje sterilizimi për fëmijët nën moshën 1 vjeçe (si dhe pelena për fëmijë)
- Detektorë tymi dhe për monoksidin e karbonit: të gjitha banesat duhet të kenë alarm për tymin në gjendje pune (në çdo kat që përdoret për banim) dhe një alarm për monoksidin e karbonit (në pronat me lëndë djegëse të ngurtë ose me gaz)
- Televizorët dhe mundësia për të pasur Wi-Fi **nuk** janë kërkesa kontraktuale dhe nuk kanë nevojë të sigurohen, megjithatë Kartat SIM vetëm me paketë interneti mund të jenë në dispozicion sipas kërkesës për sa kohë që ato janë në stok (pyesni tek Receptsi)

Ofruesi i strehimit gjithashtu është i detyruar t'ju sigurojë shtresa të reja personale kur hyni në banesë.

Peshqir Banje



2 (për person)

Peshqirë Fytyre



2 (për person)

Çarçafë



2 (për person)

Batanije dhe jorgan



2 / 1 (për person)

Peshqirë për Duart



2 (për person)

Peceta Duarsh

(vetëm për Strehimin Fillestar k... vetë)



1 (për person)

Jastëkë dhe Këllëf Jastëku



2 prej secilit (për person)

Mbulesa Jorgani



2 (për person)

Artikuj shtesë

Artikujt dhe sendet shtesë që merrni në strehimin tuaj, janë përgjegjësia juaj. Ofruesi juaj i strehimit nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi për ata artikuj.

Nuk lejohet përdorimi i ngrohësve portativë dhe do t'ju kërkohet të hidhni çdo material ose objekt të rrezikshëm.

Disa artikuj të zakonshëm të cilët ofruesi i strehimit **nuk është** i detyruar që t'i sigurojë:

- Një telefon personal (megjithatë pajisje të përbashkëta për të telefonuar duhet të vihen në dispozicion për ju)
- Lidhje interneti me Broadband / Wi-Fi
- Televizor / TV
- Fshesë me korrent (megjithatë një fshesë dhe kacia duhet të vihen në dispozicion për ju)

Nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat rezultojnë në kosto të konsiderueshme dhe që tejkalojnë nivelet standarde të mbështetjes, ju mund të keni të drejtë për pagesa shtesë. Për më shumë informacion, ju lutemi telefononi Migrant Help.

Shërbime Utilitare

Gazi, uji dhe energjia elektrike janë siguruar. Tregoni kujdes për mjedisin dhe mbani në kontroll përdorimin e këtyre shërbimeve. Oficeri i strehimit do t'ju udhëzojë se si t'i përdorni shërbimet utilitare, si për shembull si funksion ngrohja dhe ku ndodhet kutia e shpërndarjes elektrike. Ju nuk duhet të ndryshoni furnizuesin e shërbimeve tuaja.



Certifikata Shëndetësore (HC2)

Pasi t'ju jetë dhënë mbështetje në bazë të Seksionit 95, ju do të keni të drejtë për një certifikatë HC2 (ose për ata në Seksionin 4, një certifikatë HC1). Ajo përdoret që të keni mundësi të merrni:

- Trajtim dentar nga NHS
- Paruke dhe mbajtëse prej cope nga NHS
- Kontrollë për sytë, syze dhe lente kontakti; ose
- Udhëtim për të marrë trajtim nga Shërbimi Kombëtar i Shëndetit (NHS) nëse jeni referuar nga një mjek (Mjeku i Përgjithshëm ose mjeku i spitalit), mjeku i syve ose dentisti.

Ajo duhet të lëshohet automatikisht kur ju jepet mbështetje në bazë të Seksionit 95 dhe më pas të rinovohet automatikisht çdo 6 muaj. Megjithatë, nëse nuk e merrni certifikatën HC2 brenda 3 javëve nga marrja e letrës suaj për dhënien e ndihmës, ju mund të kontaktoni drejtpërdrejt me NHS për këshilla të mëtejshme në numrin 0300 330 1343. Linjat janë të hapura nga e Hëna deri të Premten, nga ora 08:00 deri në

orën 18:00 dhe të Shtunën, nga ora 09:00 deri në orën 15:00. Ky problem duhet të ngrihet edhe me Migrant Help.

Në rast se merrni mbështetje sipas Seksionit 4, ju duhet të plotësoni formularin HC1. Ai mund të merret nga farmacia juaj e zonës ose nëpërmjet faqes së internetit/qendrës së kontaktit të NHS, ku mund të kërkonti ndihmë për plotësimin e një formulari HC1. Aplikoni në internet në nhsbsa.nhs.uk. Në rast se keni nevojë për trajtim urgjent ose mjekim, NHSBSA ju këshillon të shënoni me x kutinë e përjashtimit në pjesën e pasme të çdo recete dhe të telefononi linjën e ndihmës nëse farmacia ka refuzuar t'ju japë pa paraqitur prova.

Inspektimet e pronës

Strehimi Fillestar i Pavarur

Inspektimet e pronës kryhen vetëm në strehimin fillestar të pavarur (një banesë që përdoret vetëm nga ju dhe familja juaj) për t'u siguruar që banesa është e përshtatshme dhe e sigurt për ju. Ofruesi i strehimit duhet të inspektojë banesën të paktën një herë në muaj për të identifikuar dhe rregulluar ndonjë defekt.

Ju do të njoftoheni të paktën 5 ditë më parë për datën dhe orën e inspektimeve në mënyrë që të jeni të pranishëm në pronë. Ofruesi do ta inspektojë pronën edhe në rastin kur ju nuk jeni aty.

Çfarë ndodh gjatë inspektimit?

Inspektori duhet të trokasë gjithmonë në derë dhe të presë që ju të përgjigjeni. Ata nuk duhet të hapin derën pa prituri. Ata nuk duhet të përdorin çelësin e tyre kur jeni në dhomë. Ata do të flasin me ju në lidhje me pronën dhe do të kontrollojnë për ndonjë defekt. Në rast se gjenden defekte, ato do të raportohen për riparim. Duhet të vihet në pah çdo defekt që nuk është i dukshëm për inspektorin.

As ofruesit, dhe as personeli i Zyrës së Brendshme nuk kanë të drejtë të kontrollojnë sendet tuaja personale. Megjithatë, në rast se ju largoheni nga prona dhe lini pas sende personale, ato do të paketohen nga ofruesi juaj dhe do të vendosen në ruajtje afatshkurtër deri në 28 ditë, dhe nëse nuk mblidhen gjatë kësaj kohe, ato do të asgjësohen.

Kush e kryen inspektimin?

Inspektimet e pronave do të kryhen të paktën çdo muaj nga ofruesi i strehimit. Një nga zyrtarët e Home Office [Zyrës së Brendshme] ose këshillit vendor mund të kryejë gjithashtu një inspektim për t'u siguruar se ofruesi i strehimit i përmbush standardet e kërkuara.



Po në rast se banoj në hotel / strehim IA?

Strehimi Fillestar ka disa forma, duke përfshirë strehim me ushqim, hotele dhe bujtina. Këto vende inspektohen çdo 6 muaj nga Zyra e Brendshme.

Si mund të raportoj një defekt?

Defektet që gjenden në pronë duhet të raportohen te Migrant Help në mënyrë që ato të regjistrohen dhe rregullohen. Ofruesit e strehimit punojnë për të rregulluar defektet brenda afateve kohore të përcaktuara (shihni "Riparimet dhe mirëmbajtja"). Në rast se ju ka ndodhur një defekt, ju nuk duhet të prisni deri në inspektimin e planifikuar për ta raportuar atë.

Përdorimi i strehimit

Ofruesi i strehimit mban një çelës kopje ose çelësin kryesor për pronën e cila ruhet në mënyrë të sigurt. Zakonisht, hyrja në pronë për riparime dhe inspektime do të bëhet ndërkohë që ju jeni i pranishëm.

në rast se nevojitet punë thelbësore në një njoftim të shkurtër, ofruesi juaj do t'ju kontaktojë për t'ju treguar se kur do të vijë në pronë. Në rast se nuk keni mundësi të jeni në atë moment, ofruesi mund të përdorë çelësin e tij për të hyrë në pronë.

Në rast se nuk keni mundësi të jeni në kohën e takimit, ofruesi mund të hyjë gjithsesi në mjediset e banimit, duke përdorur një çelës dublikat.

Vizitorët lejohen në Strehimin Fillestar, por ju lutemi informoni personelin e receptionit për datën dhe orën e mbërritjes së vizitorëve në mënyrë që të mund t'ju sigurojnë atyre hyrje të shpejtë në mjedise. Ju lutemi vini re gjithashtu se vizitorët nuk lejohen të qëndrojnë në këto mjedise gjatë natës.



Riparime dhe mirëmbajtja

Ofruesit e strehimit punojnë për të rregulluar çdo defekt brenda afateve kohore të përcaktuara në varësi të llojit të problemit. Tabela më poshtë shpjegon klasifikimet e ndryshme të defekteve, kohët e përgjigjes dhe disa shembuj të defekteve. Në rast se nuk jeni të sigurt për klasifikimin e mirëmbajtjes, ose nëse defekti i raportuar nuk rregullohet brenda periudhës së përcaktuar, ju duhet të kontaktoni Migrant Help.



Klasifikimi i mirëmbajtjes	Kuptimi	Koha e përgjigjes	Shembull i defektit
Kategoria 1	Një defekt që paraqet ose mund të përbëjë rrezik për shëndetin, sigurinë ose mbrojtjen tuaj, ose ndërprerja ose humbja e një shërbimi thelbësor të strehimit	Shërbimi telefonik është i disponueshëm 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, në mënyrë që problemet të mund të hetohen dhe rregullohen (ose t'ju sigurohet strehim alternativ i përkohshëm) brenda 4 orëve nga momenti kur ofruesi është vënë në dijeni për problemin që lidhet me mirëmbajtjen.	<ul style="list-style-type: none"> • Rrjedhje e gazit • Përmbytje • Paqëndrueshmëri strukturore • Nuk ka furnizim me ujë • Dëmtim nga zjarri
Kategoria 2	Një defekt që mund të shkaktojë një efekt negativ për shëndetin, sigurinë nga rreziku ose mbrojtjen tuaj ose që ka një ndikim të rëndësishëm tek prona ose cilësia e jetës.	24 orë për të bërë një riparim të sigurt, 5 ditë pune për të bërë një riparim të përhershëm. Në rast se ofruesi nuk mund ta bëjë strehimin të sigurt brenda 24 orëve, juve duhet t'ju sigurohet një strehim alternativ i përkohshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka furnizim me ujë të nxehtë • Sistemi i ngrohjes nuk funksionon • Nuk ka furnizim me energji elektrike • Nuk ka asnjë alarm tymi ose zjarri në gjendje pune • Infektim nga parazitë i cili paraqet një rrezik të rëndë për shëndetin dhe sigurinë
Kategoria 3	Një defekt që ka të ngjarë ose mund të shkaktojë një efekt negativ në komoditetin dhe mirëqenien tuaj ose që mund të shkaktojë dëme të mëtejshme në pronë nëse nuk trajtohet	21 ditë pune	<ul style="list-style-type: none"> • Bojë që Hiqet • Shenja të rëndësishme të lagështisë dhe rritjes së mykut • Pllaka muri dhe dyshemeje të cilat janë dëmtuar ndjeshëm • Infektim të tjera nga parazitët

Informacion shtesë për strehimin

Siguria nga Zjarri

Të gjitha strehimet e përdorura nga ofruesit tanë duhet të pajisen me një alarm tymi. Në rast se në banesë ka zjarr, tymi do të aktivizojë alarmin dhe alarmi do të lëshojë një zhurmë "bip" në mënyrë të vazhdueshme.

Me zbulimin e zjarrit, ju dhe familja juaj duhet:

- > Të aktivizoni alarmin më të afërt të zjarrit
- > të largoheni menjëherë nga mjediset sipas udhëzimeve të përcaktuara nga menaxheri i mjedisit dhe të shkoni në pikën e caktuar të takimit
- > të mos ndaloni për të mbledhur sendet personale
- > të largoheni nga ndërtesa nga dalja më e afërt e sigurt
- > të telefononi Shërbimin Zjarrfikës dhe të Shpëtimit në numrin 999 dhe të njoftoni ofruesin tuaj të strehimit


Mos e hiqni baterinë, mbuloni apo ndërhyni tek alarmi i tymit pasi kjo mund të rrezikojë jetën tuaj. Ju lutemi informoni një anëtar të personelit sa më shpejt të jetë e mundur nëse ka ndonjë problem të njohur me alarmin e zjarrit.

Nëse banoni në Strehim Fillestar me vetë-shërbim, detektori juaj i tymit do të testohet çdo muaj kur prona të inspektohet. Nëse alarmi fillon të bie me ndërprerje, kjo do të thotë se bateria duhet të zëvendësohet. Kontaktoni Migrant Help dhe kërkoni që bateria të zëvendësohet.

Pastrimi

Është e rëndësishme që ta mbani banesën tuaj të pastër dhe të rregullt. Disa forma të strehimit fillestar (të tilla si hotelet dhe bujtinat) ofrojnë shërbime javore pastrimi të dhomave të gjumit dhe zonave komunale; megjithatë është përgjegjësia juaj të ruani pastërtinë e mjedisit tuaj. Nëse banesa nuk mbahet pastër, kjo mund të çojë në shfaqjen e parazitëve dhe të rrezikojë sigurinë e njerëzve. Ju jeni përgjegjës për ruajtjen e standardeve të pastërtisë brenda banesës tuaj.

Nëse jetoni në një bujtinë ose strehim ku gatvani vetë, ofruesi juaj i strehimit është përgjegjës për pastrimin e rregullt të zonave të përbashkëta, megjithëse ju dhe banorët e tjerë duhet



të kujdeseni për këto zona. Për të ndihmuar me këtë, do të sigurohet mundësia për përdorimin e materialeve dhe artikujve të konsumit që janë të përshtatshme për pastrimin e zonave të përbashkëta, duke përfshirë, por jo vetëm, zbardhuesin, pastruesin e dyshemesë, lëngun për larjen e enëve dhe pastruesin e banakut të punës.

Mbledhja e koshave (strehimi ku gatuhet vetë)


Plehrat duhet të vendosen në koshin e duhur me rrota ose koshin e riciklimit. Këshilli vendor i zbraz ato rregullisht, prandaj sigurohuni që t'i nxirrni koshat për mbledhje në ditën e duhur. Hedhja e mbeturinave në rrugë apo zona të tjera publike është e paligjshme. Kjo njihet si hedhje e mbeturinave. Nëse shpalleni fajtor për hedhjen e mbeturinave, ju mund të gjobiteni ose burgoseni.



Udhëtimi

Të gjithë përdoruesit e shërbimit që marrin mbështetje sipas Seksionit 98 dhe Seksionit 4 kanë të drejtë të marrin ndihmë për organizimin e udhëtimit me transport, blerjen e biletave të transportit publik ose pagesat e shumës së përgjithshme për të mbuluar kostot e udhëtimit në rrethana të caktuara. Këto mund të përfshijnë udhëtimin për:


- në Zyrën e Regjistrimit të Lindjeve dhe vdekjeve për të regjistruar lindjen e një fëmije ose vdekjen e një të afërmi.
- takimin me mjekun, dentistin ose spitalin; dhe/ose
- takimin para lindjes ose pas lindjes.



Kostot e udhëtimit mbulohen nga shuma e ndihmës financiare që marrin përfituesit e Seksionit 95, prandaj nuk do të jepet asistencë shtesë siç është përcaktuar më sipër.

Posta

Posta juaj është personale. Konsiderohet vepër penale ndërhyrja në postën e një personi tjetër. Në rast se merrni një postë e cila i drejtohet dikujt që nuk jeton në pronë, ju lutemi t'ia kaloni atë oficerit të strehimit. Pjesa më e madhe e korrespondencës nga Zyra e Brendshme do të dërgohet me postë, prandaj është e rëndësishme që të pyesni rregullisht personelin e recepsionit në hotel ose të kontrolloni rregullisht kutinë tuaj postare në strehimin e pavarur dhe të informoni Zyrën e Brendshme për çdo ndryshim të adresës.



Lëvizjet dhe kërkesat për zhvendosje

Juve mund t'ju kërkohe të zhvendoseni herë pas here. Për shembull, nëse zhvendoseni në strehim për shpërndarje, nëse pronari i strehimit dëshiron të rimarrë banesën tuaj, nëse ekzistojnë shqetësime në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat ligjore për shëndetin dhe sigurinë, ose të mundësohet strehimi i një përdoruesi shërbimi me nevoja të veçanta, ose kur në pronë janë të nevojshme punime të rëndësishme për mirëmbajtjejen. Zyra e Brendshme dhe ofruesi juaj i strehimit do të sigurohen që nevojat tuaja të vazhdojnë të plotësohen kudo që të strehoheni, por strehimi nuk ofrohet në bazë të zgjedhjes, prandaj nuk është gjithmonë e mundur të garantohet se do të

qëndroni në të njëjtën zonë. Në rast se duhet të lëvizni, do t'ju dërgohet një letër ku konfirmohen organizimet që janë bërë. Letra do t'ju dërgohet me email, nëse keni një të tillë, ose me postë. Si rregull i përgjithshëm, ofruesi i shërbimit do t'ju njoftojë 5 ditë përpara, kur është e mundur, por kjo nuk është gjithmonë e mundur kur lëvizja duhet të bëhet me një njoftim të shkurtër (për shembull, kur strehimi me shpërndarje lirohet ose kur ka një shqetësim në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në strehimin ku qëndroni aktualisht).

Edhe pse nuk do t'ju jepet një adresë e saktë se ku do të lëvizni paraprakisht, ju do të njoftoheni për vendndodhjen (p.sh., qyteti ose komuna) dhe ofruesi do të organizojë transportin që t'ju çojë në strehimin tuaj. Bagazhi i lejuar është **dy bagazhe për person**, përveç lodrave dhe artikujve të tjerë për fëmijë, artikujve për kujdesin e foshnjave, pajisjeve mjekësore, karrocave për fëmijë dhe/ose karrocave dhe mjeteve ndihmëse për aftësinë e kufizuar, nëse ka.

Megjithatë, Zyra e Brendshme duhet të marrë në konsideratë kërkesat për strehim në një vendndodhje të caktuar - udhëzimet për ndarjet e banesave mund të gjenden këtu: [Kërkesat për strehimin në azil: një udhëzues për punonjësit e çështjeve - GOV.UK \(www.gov.uk\)](http://www.gov.uk) . Nëse mendoni se strehimi juaj aktual ose i propozuar është i papërshtatshëm ose nuk i plotëson nevojat tuaja individuale, ju lutemi jepni prova mbështetëse për Migrant Help, i cili do t'i ndajë ato me Zyrën e Brendshme për shqyrtim. Megjithatë, kur nuk ka kufizime për të cilat është rënë dakord, ju pritët të pranoni ofertën për strehim ashtu siç është bërë.

Seksioni 5

Pagesat e parave dhe mbështetjes




Nëse jeni në strehim fillestar, ofruesi i strehimit do t'i plotësojë nevojat tuaja bazë për jetesë duke ju siguruar strehim me shërbim dhe ushqim dhe akses ndaj artikujve të tjerë për të përmbushur nevojat tuaja bazë të jetesës (të tilla si artikuj tualeti, pastrimi ose produkte të higjienës për femrat). Në rast se ju jepet mbështetja në bazë të Seksionit 95 / Seksioni 4, nëse ende banoni në Strehim Fillestar me ushqim ndërkohë që prisni shpërndarjen, ju do të merrni një pagesë javore para shpërndarjes prej 9.58 £ në javë (e saktë që nga Gushti 2023) derisa t'ju sigurohet strehim ku të gatvani vetë. Ju do të pajiseni me Kartën Aspen pasi t'ju jepet mbështetja në bazë të Seksionit 95, dhe kjo kartë do t'ju postohet në adresën tuaj. Në rast se nuk e merrni kartën pas marrjes së letrës suaj të Grantit sipas Seksionit 95, ju lutemi kontaktoni Migrant Help për t'i njoftuar ata, por jini të sigurtë që çdo ndihmë që ju takon do të kreditohet në kartë, pavarësisht nëse ajo është gati për t'u përdorur, pasi ta keni marrë kartën tuaj. Ju duhet të kontaktoni Migrant Help në rast se keni ndonjë shqetësim apo pyetje në lidhje me nivelin tuaj të ndihmës financiare, ose nëse e humbni kartën tuaj Aspen pasi të jetë lëshuar. Karta juaj Aspen përdor teknologjinë Chip-and-Pin dhe duket si imazhi më poshtë.

Pasi të keni kaluar në një pronë të pavarur, shuma e mbështetjes financiare do të rritet në 47.39 £ në javë (shifër e saktë që nga Gushti i vitit 2023), në mënyrë që të mbuloni shpenzimet tuaja bazë të jetesës dhe ato të anëtarëve të familjes tuaj që varen nga ju. Me mbështetjen e marrë në bazë të Seksionit 95, ju mund të merrni pagesa me para në dorë nëpërmjet "Kartës Aspen" për të blerë ushqime dhe sende të tjera për të mbuluar nevojat tuaja bazë të jetesës. Në të njëjtën mënyrë, nëse jetoni në një strehim fillestar me vetë-gatim, ju do të merrni më shumë ndihmë financiare për të mbuluar kostot e blerjes së ushqimit tuaj.

Informacion në lidhje me kartën tuaj Aspen

- Ajo nuk është një kartë krediti dhe nuk krijon një llogari bankare. Vetëm Zyra e Brendshme mund të hedhë para në kartën tuaj, prandaj ju nuk mund ta përdorni atë për të marrë pagesa nga të tjerët.
- Zyra e Brendshme do t'ju njoftojë për shumën e mbështetjes financiare që keni të drejtë të merrni, dhe kjo shumë do të hidhet në kartën tuaj çdo javë. Bilanci juaj do të kalojë nga java në javë.



- Ju mund të shpenzoni vetëm fondet që janë në dispozicion në kartë. Përpara se të blini diçka, ju duhet të siguroheni se keni fonde të mjaftueshme, përndryshe pagesa mund të refuzohet.
- Karta duhet të përdoret vetëm nga personi të cilit i është caktuar PIN-i. Është përgjegjësia juaj që të siguroheni që karta të ruhet e sigurt. Nëse familja juaj është duke marrë mbështetje, aplikanti kryesor (personi që ka aplikuar për mbështetje) do të mbajë kartën Aspen për familjen.
- Zyra e Brenshme mund të rishikojë përdorimin e kartave për t'u mbrojtur nga mashtrimet dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e përdoruesve të shërbimit tonë.
- Data e skadimit në kartë nuk do të thotë se ajo është data kur do të përfundojë mbështetja. Në rast se jeni ende duke marrë mbështetje financiare kur karta skadon ajo do të rinovohet.
- Ju nuk mund të bëni pagesa pa kontakt, pagesa për telefonin ose internetin ose të përdorni kartën tuaj jashtë vendit.
- Ju mund të jeni i kufizuar për të përdorur kartën tuaj për të blerë mallra dhe shërbime të caktuara. Për shembull, ju nuk mund ta përdorni kartën tuaj për udhëtime me autobus/tren. Ju lutemi kontaktoni Migrant Help nëse keni nevojë për këshillim mbi pagesat shtesë nëse shkoni tek një ofrues i kujdesit shëndetësor.

Ju mund ta përdorni kartën tuaj Aspen për të:

- paguar për transaksionet me pakicë në shumicën e dyqaneve me logon Mastercard deri në vlerën e gjendjes tuaj që është në dispozicion.
- kontrolluar gjendjen tuaj të mbetur në një ATM, e cila quhet gjithashtu makinë për paratë
- tërhequr para nga një makinë parash, deri në vlerën e 200 £, por keni kujdes pasi disa makina parash ju mbajnë para për këtë
- marrë para mbrapsht kur blini diçka në dyqanet që marrin pjesë në programin Mastercard.

Megjithatë, nëse jeni një azilkërkues të cilit i është refuzuar kërkesa dhe jeni duke marrë mbështetje në bazë të Seksionit 4, ju nuk mund të tërhiqni para nga një ATM ose të merrni para mbrapsht nga dyqanet.

Kontaktoni Migrant Help në numrin **0808 8010 503** sa më shpejt të jetë e mundur nëse:

- pagesa që prisni nuk merret, ose merrni një shumë të gabuar
- karta juaj humbet, dëmtohet ose vidhet (për ta anuluar atë dhe për të marrë një kartë zëvendësuese)

Pagesa ekstra

Në rast se mendoni se keni të drejtë për ndonjë pagesë shtesë, kontaktoni Migrant Help në numrin 0808 8010 503. Informacioni më poshtë shpjegon disa nga rastet kur ju mund të klasifikoheni:

Shtatzënia.

- Në rast se jeni shtatzënë dhe merrni mbështetje në bazë të Seksionit 95 ose 98 të Ligjit për Imigracionin dhe Azilin 1999, ju mund të keni të drejtë për një


pagesë të njëhershme prej 300 £ për të mbuluar shpenzimet e lindjes së fëmijës suaj. Në rast se merrni mbështetje në bazë të Seksionit 4, kjo do të jetë një pagesë e njëhershme prej 250 £.

- Ju duhet të bëni një kërkesë me shkrim për këtë grant ndërmjet 8 javëve para lindjes së foshnjës tuaj dhe 6 javë pas lindjes. Për të aplikuar përpara se foshnja juaj të lindë, ju duhet t'i siguronit Migrant Help një vërtetim mjekësor zyrtar për datën e pritshme të lindjes, si p.sh. certifikatën origjinale MATB1 ose prova të tjera mjekësore për shtatzëninë.
- Ju gjithashtu mund të aplikoni nëse fëmija juaj ka lindur jashtë Mbretërisë së Bashkuar dhe fëmija juaj është më pak se 3 muajsh ose në raste të tjera të jashtëzakonshme. Ju duhet të siguronit prova të besueshme për moshën e fëmijës, të cilat zakonisht vërtetohen nga certifikata e plotë origjinale e lindjes së foshnjës.
- Ndërkohë që jeni në strehim me shpërndarje ju gjithashtu keni të drejtë të merrni 3 £ shtesë në javë gjatë shtatzënisë tuaj. Kjo njihet si pagesa e shtatzënisë, e cila jepet për të blerë ushqime shtesë të shëndetshme.
- Për Pagesat e Shtatzënisë mund të aplikohet me shkrim nëpërmjet Migrant Help në çdo kohë përpara se fëmija të lindë. Ju duhet të paraqisni dokumente mjekësore të cilat konfirmojnë shtatzëninë, si për shembull certifikata origjinale MATB1, një letër nga Mamia në Komunitet ose një letër nga Mjeku i Përgjithshëm.
- Pasi fëmija juaj të lindë, ju mund të aplikoni për një shtesë prej 5 £ në javë mbi pagesat tuaja të zakonshme deri në ditëlindjen e tyre të parë dhe 3 £ për të gjithë fëmijët e tjerë të moshës 1 deri në 3 vjeç në rast se jetoni në strehim të përkohshëm ose me vetë-shërbim. Për t'u kualifikuar për këtë financim, ju duhet të siguronit origjinalin e certifikatës të plotë të lindjes dhe dëshminë mjekësore që konfirmon lindjen e fëmijës suaj, dhe ta bëni këtë brenda 6 javësh nga lindja. Ju duhet të aplikoni nëpërmjet Migrant Help - Rrethana të jashtëzakonshme
- Personat të cilët marrin mbështetje në bazë të Seksionit 4, kanë të drejtë të marrin 3 £ në javë gjatë gjithë periudhës së shtatzënisë.
- Nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat rezultojnë në kosto të konsiderueshme dhe që tejkalojnë nivelet standarde të mbështetjes, ju mund të keni të drejtë për pagesa shtesë (kjo njihet si pagesë **në bazë të Seksionit 96**. Për shembull, nëse duhet të udhëtoni në distanca të gjata për takime mjekësore (për këtë duhet të aplikohet përpara udhëtimit) ose nëse keni një gjendje shëndetësore që kërkon një dietë të veçantë. Ju lutemi kontaktoni Migrant Help dhe plotësoni [formularin e aplikimit ASF2](#).



Seksioni 6

Vazhdimi pas vendimit në lidhje me kërkesën për azil



Pasi të jetë marrë një vendim në lidhje me kërkesën tuaj për azil (përfshirë ankimet), normalisht ju nuk do të keni më të drejtë për mbështetje nga Zyra e Brendshme. Në këtë rast, ju do të njoftoheni se mbështetja juaj financiare do të ndërpritet dhe se duhet të largoheni nga strehimi (fillestar ose me shpërndarje).

Ajo që duhet të bëni më tej do të varet nga fakti nëse kërkesa juaj për azil ka qenë e suksesshme. Migrant Help do t'ju kontaktojë menjëherë pasi të keni marrë vendimin dhe do t'ju ofrojë këshillim për hapat e ardhshëm. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Ekipin për të Pastrehët të Autoritetit Vendor për këshilla të mëtejshme.

Pasi të merrni vendimin që është marrë ndaj jush, ju keni 28 ditë kohë për të dalë nga strehimi nëse ju është dhënë Leja e Qëndrimit (LTR) dhe 21 ditë nëse keni marrë një vendim negativ. Para se të largoheni nga banesa, ju lutemi sigurohuni që të gjitha sendet tuaja personale të jenë të paketuara, banesa të jetë e pastër dhe e rregullt dhe se nuk keni lënë sende personale. Çdo send që mbetet pasi të largoheni do të ruhet për 28 ditë para se të hidhet.

Kërkesa të suksesshme

Në rast se ju jepet leje për të qëndruar në MB - statusi i refugjatit, leje diskrecionale ose mbrojtje humanitare, ju keni të drejtë të punoni, të kërkonit përfitime bazë, dhe të kërkonit strehim privat (edhe pse ju mund të keni të drejtë për përfitimin e strehimit social) dhe të merrni mbështetje për ta bërë këtë në të njëjtën mënyrë si banorët e tjerë të Mbretërisë së Bashkuar. Ju do të merrni një Leje Qëndrimi Biometrike, të cilën mund ta përdorni për të treguar se jeni kualifikuar.

E drejta juaj për mbështetje për azil përfundon 28 ditë pas datës që ju jepet leja (duke lejuar edhe 2 ditë shtesë për vonesat për shkak të shërbimeve postare, të cilat duhet të mbulojnë periudhën nga dërgimi tek marrja). Ju do të merrni një letër e cila konfirmon datën e saktë se kur do të përfundojë mbështetja juaj për azil. Është veçanërisht e rëndësishme që të filloni të planifikoni hapat e ardhshëm sapo të merrni letrën tuaj, pasi mund të duhet pak kohë për ta marrë veten nga momenti i ndërprerjes së mbështetjes për azil. Zyra e Brendshme nuk do të mund ta zgjasë mbështetjen tuaj përtej 28 ditëve.

Gjetja e një pune ose kërkimi i përfitimeve

Ju duhet të kërkoni punë dhe/ose të kërkoni përfitime. Jobcentre Plus është shërbim qeveritar i cili trajton këto çështje. Migrant Help mund t'ju mbështesë në lidhje me këtë dhe do t'ju kontaktojë për t'ju ndihmuar të caktoni takimin tuaj të parë me Jobcentre Plus. Është e rëndësishme që ta bëni këtë sa më shpejt të jetë e mundur.



Gjetja e strehimit alternativ

Ju duhet ta gjeni vetë strehimin tuaj. Ai mund të jetë strehim me qira, strehim si pjesë e paketës së punës, bujtinë, banesë, ose shtëpi e përbashkët të cilën e paguani vetë. Përveç Migrant Help, departamenti i strehimit i këshillit tuaj vendor mund të ofrojë këshillim dhe ndihmë. Megjithatë, ju lutemi kini parasysh se ndoshta ju duhet ta gjeni vetë strehimin tuaj dhe mund të prisni që të strehoheni nga Autoriteti Vendor vetëm nëse keni nevoja të tjera, për shembull nëse jeni veçanërisht vulnerabël ose keni fëmijë.

Hapja e llogarisë bankare

Ju duhet të hapni një llogari bankare (nëse nuk e keni tashmë një të tillë) në mënyrë që të merrni çdo përfitim që ju paguhet dhe të paguani qiranë nëse është e nevojshme. Banka të ndryshme kërkojnë informacione të ndryshme për të hapur një llogari, por të gjitha duan të shohin prova të identitetit tuaj, siç është Leja juaj Biometrike e Qëndrimit.

Kërkesa të pasuksesshme

Nëse nuk keni fëmijë në familjen tuaj, e drejta juaj për mbështetje për azil do të ndërpritet pas 21 ditësh. Ju do të merrni një letër ku tregohet data e saktë se kur duhet të largoheni nga strehimi juaj. Në të ju këshilloheni se si të aplikoni për mbështetje të mëtejshme në rast se jeni duke ndërmarrë hapa për t'u larguar nga Mbretëria e Bashkuar, por nuk besoni se mund të niseni brenda 21 ditëve. Kjo formë e mbështetjes njihet si "mbështetje në bazë të seksionit 4" dhe gjithashtu mund të jetë në dispozicion në disa rrethana të tjera, të cilat do t'ju shpjegohen në letrën që do të merrni. Ju gjithashtu mund të merrni këshilla nga Migrant Help në lidhje me Mbështetjen sipas Seksionit 4.

Nëse keni fëmijë nën moshën 18 vjeç në familjen tuaj në kohën kur kërkesa dhe çdo ankim që keni bërë ju është refuzuar, ndihma për azil nuk do të ndërpritet automatikisht.

Në rast se kërkesa juaj (përfshirë ankimet) është refuzuar, nga ju pritet që të ndërmerrni hapat e nevojshëm për t'u larguar nga Mbretëria e Bashkuar. Zyra e Brendshme ofron shërbimin e kthimit vullnetar, i cili mund t'ju ndihmojë të bëni organizimet e nevojshme. Për më shumë informacion në lidhje me këtë mund të vizitoni faqen www.gov.uk/return-home-voluntarily ose telefononi Shërbimin për Kthimin Vullnetar në numrin: **0300 004 0202**.

Migrant Help UK do t'ju kontaktojë menjëherë pasi të merret një vendim për ju dhe do t'ju këshillojë mbi hapat e ardhshëm, përfshirë informacion dhe përfitimet që ofron Shërbimi për Kthimin Vullnetar.

Në rast se keni nevojë për më shumë informacion në lidhje me procesin e aplikimit për azil, shërbimet mbështetëse që janë në dispozicion ose informacion mbi të drejtat dhe përgjegjësitë ndërkohë që jeni në Mbretërinë e Bashkuar, ai mund të gjendet këtu: [Broshurë informuese për kërkesën tuaj për azil - GOV.UK \(www.gov.uk\)](#)

Seksioni 7 Kontakte të dobishme



Kontakte për raste emergjente:

Shërbimet e Urgjencës (Shërbimi Zjarrfikës / Policia/Ambulanca): **999**

Policia Raste Jo-Urgjente: **101**

NHS Raste Jo-Urgjente: **111**

National Grid Gas [Rrjeti Kombëtar i Gazit]:

Anglia, Skocia dhe Uells: **0800 111 999**

Irlanda e Veriut: **0800 002 001**

Migrant Help:

Webchat: https://ellis.custhelp.com/app/chat/chat_launch

Ngrini një Problem: (<https://ellis.custhelp.com/app/ask/session>)

Linja e ndihmës pa pagesë: **0808 8010503**.

Këto shërbime janë në dispozicion 24 orë në ditë, 7 ditë në javë dhe ofrojnë shërbime të plota përkthimi.

www.migranthelpuk.org

Home Office [Ministria e Brendshme]

Informacion në lidhje me kërkesën për azil dhe mbështetje për azil:

www.gov.uk/browse/Mastercards-immigration/asylum

Ankimet kundër Mbështetjes për Azil:

www.gov.uk/courts-tribunals/first-tier-tribunal-asylum-support

Gjeni një këshillues juridik:

www.gov.uk/find-a-legal-adviser

Shërbimi për Kthimin Vullnetar:

Faqja e internetit: www.gov.uk/return-home-voluntarily

Telefon: **0300 004 0202**

Organizatat bamirëse:

Refugee Action: www.refugee-action.org.uk

Refugee Council [Këshilli për Refugjatët]: www.refugeecouncil.org.uk

Asylum Support Appeals Project [Projekti për Ankimin për Mbështetjen për Azil]:

www.asaproject.org

Childline (Ofron këshillim dhe mbështetje konfidenciale pa pagesë për personat nën moshën 18 vjeç) Telefon pa pagesë: 0800 1111 <https://www.childline.org.uk/>



© E Drejta e Autorit të Kurorës 2022

Ky publikim është i licencuar në përputhje me kushtet e Licencës së Open Government Licence v3.0, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe. Për të parë këtë licencë, vizitoni faqen nationalarchives.gov.uk/doc/open-government-licence/version/3

Aty ku kemi identifikuar informacion mbi të drejtën e autorit të palëve të treta, ju duhet të merrni leje nga mbajtësit përkatës të së drejtës së autorit.